



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

**RREGULLORE**

**“PËR PËRCAKTIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË DHURUESVE  
TË GJAKUT ”**

TIRANË 2015

## **KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Baza ligjore**

Rregullorja “Për përcaktimin e përshtatshmërisë së dhuruesve të gjakut” bazohet në nenin 25 të ligjit nr.9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si edhe ne Direktivën 2004/33/CE të Këshillit të Europës të datës 22 Mars 2004.

### **Neni 2 Objekti rregullores**

1. Në këtë rregullore përmblihen veprimet, që duhet të kryhen gjatë procedurës së seleksionimit të dhuruesve të gjakut dhe dokumentacioni përkatës që plotësohet gjatë kësaj procedure.
2. Rregullorja rishikohet çdo dy vjet, në mënyrë që të pasqyrojë sa më qartë ndryshimet në nivel ndërkombëtar drejtpërsëdrejti të lidhura me cilësinë dhe sigurinë e gjakut dhe produkteve, në raport me sigurinë e dhuruesit dhe marrësit.

### **Neni 3 Përkufizime**

1. Dhurues: Quhet çdo person i shëndetshëm i cili dhuron gjak apo komponentë në mënyrë vullnetare, me qëllim përdorimin terapeutik të tyre.
2. Kandidat për dhurues: Quhet çdo person i cili paraqitet pranë një strukture transfuzionale apo njësie mbledhëse lëvizëse dhe deklaron se dëshiron të dhurojë gjak apo komponentë.
3. Dhurues për herë të parë: Quhet çdo person i cili dhuron gjak apo komponentë për herë të parë.
4. Dhurues periodik: Quhet çdo person që dhuron gjak shpesh (të paktën një herë në dy vitet e fundit).
5. Gjak Quhet çdo njësi gjaku të plotë autolog ose allogjen
6. Komponentë: produktet që rrjedhin nga fraksionizmi i gjakut me aferezë ose me ndarje pas dhurimit të gjakut të plotë.

## **KREU II**

### **Informimi dhe ruajtja e konfidencialitetit**

#### **Neni 4**

#### **Sensibilizimi dhe informimi i kandidatit për dhurues vullnetar gjaku**

Kryqi i Kuq, organizata e dhuruesve vullnetarë të gjakut apo OJF e tjera të përfshira në promocionin e dhurimit vullnetar e falas të gjakut bashkëpunojnë me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut për të vënë në dispozicion të gjithë kandidatëve për dhurues të gjakut dhe/ose komponentëve, materiale edukative të përgatitura me kujdes dhe të kuptueshme mbi karakteristikat e gjakut, të komponentëve dhe mbi të mirat që pacientet marrin nga dhurimi. Pjesë e materialeve edukuese për dhuruesit e gjakut janë si më poshtë:

1. Motivi për të cilin kërkohen, plotësohen dhe kryhen pyetësi, anamneza, ekzaminimi objektiv, të dhënat fizike dhe testimet biologjike të çdo dhurimi gjaku.
2. Informacioni mbi riskun e transmetimit të sëmundjeve infektive të transmetueshme nëpërmjet transfuzionit të gjakut dhe komponentëve të tij.
3. Kuptimin e fjalëve: pëlqimi i dhuruesit, vetëpërrjashtim dhe përjashtim i përhershëm apo i përkohshëm.
4. Motivet për të cilat nuk duhet të dhurojnë gjak ata të cilët nga dhurimi i gjakut mund të kenë probleme për shëndetin e tyre.
5. Motivet për të cilat nuk duhet të dhurojnë gjak ata të cilët me dhurimin e tyre mund të dëmtojnë dhe vënë në rrezik shëndetin e marrësit të gjakut, sikurse është rasti i atyre që janë të prekur nga virusi HIV/SIDA dhe/ose nga hepatite ose që janë toksikodipendent, përdorin medikamente të pa rekomanduara nga mjeku intravenoz ose intramuskular, përdoruesit e substancave narkotike, steroideve, hormone etj.
6. Informacione specifike mbi natyrën e procedurave të dhurimit të gjakut.
7. Informimi i dhuruesve për mundësinë që ata a kanë për të bërë pyetje në çdo moment të procedurës.
8. Informim mbi mundësinë që ata kanë për ta shtyrë dhurimin apo për ta ndërprerë atë në çdo moment të procedurës.
9. Informacionin dhe sigurinë se në momentin që testet do të nxjerrin në pah patologji të mundshme, dhuruesi do të informohet me kujdes nga struktura transfuzionale dhe dhurimi i tij nuk do të përdoret.
10. Motivet për të cilat është e domosdoshme që dhuruesi në mënyrë të menjëhershme të njoftojë strukturën transfuzionale, për çdo sëmundje që mund të shfaqet pas dhurimit të gjakut sidomos hepatit viral në çdo formë që ai do të shfaqet, me qëllim ruajtjen e shëndetit të pacientit.

## **Neni 5**

### **Ruajtja e konfidencialitetit**

Personeli shëndetësor i gjithë strukturës transfuzionale dhe në veçanti personeli i njësisë mbledhëse të gjakut ka për detyrë të:

1. Garantojë që biseda me kandidatin për dhurues kryhet në kushtet e konfidencialitetit.
2. Marrë të gjitha masat e duhura për të garantuar ruajtjen e konfidencialitetit për informacionin shëndetësor të dhënë nga kandidati dhurues, për rezultatet e testeve të kryera mbi dhurimin, si edhe për procedurat e lidhura me hetimin retrospektiv në se do të paraqitet nevoja.
3. Garantojë dhuruesit mundësinë që t'i kërkojë personelit mjekësor të strukturës transfuzionale që të mos përdorë dhurimin e tij, dhe këtë ta bëjë nëpërmjet një procedure të mirëpërcaktuar vetë-përrjashtimi.
4. T'i komunikojë dhuruesit çdo lloj ndryshimi klinik të vërejtur gjatë vlerësimit paradhurimit dhe/ose në ekzaminimet e kontrollit.

## **Kreu III**

### **Përshtatshmëria për dhurim dhe ekzaminimi i dhuruesve të gjakut**

## **Neni 6**

### **Kritere të përgjithshme për seleksionimin e dhuruesve të gjakut**

1. Pranë çdo strukture transfuzionale ku mblidhet gjak, pasi verifikohet vullneti për dhurim i kandidatit dhurues për të kryer një dhurim gjaku, zbatohet procedura e seleksionimit që garanton përshtatshmërinë e dhuruesit.
2. Procedura e seleksionimit përmbledhet në sa më poshtë:
  - a. Sqarim i identitetit të kandidatit për dhurues dhe plotësim i pyetësorit.
  - b. Vlerësim i gjendjes së përgjithshme të shëndetit të kandidatit për dhurues.
  - c. Qartësim i të dhënave fizike për pranimin.
  - d. Marrje e konsentit për dhurimin dhe për trajtimin e të dhënave personale.

## **Neni 7**

### **Identifikimi i kandidatit dhurues dhe plotësimi i pyetësorit**

1. Mjeku përgjegjës për seleksionimin apo personeli shëndetësor i trajnuar në mënyrë të posaçme dhe që punon nën përgjegjësinë e mjekut, pasi qartëson identitetin e dhuruesit, mbledh të dhënat anamnesticke të nevojshme për vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për dhurues mbi bazën e pyetësorit (shiko Aneksi 1 pjesa A). Në bazë të këtyre të dhënave të mbledhura mjeku vendos përshtatshmërinë e dhuruesit për të dhuruar gjak, apo përjashtimin e përhershëm

- ose të përkohshëm të tij sipas kritereve të përcaktuara në Aneksin 4, me qëllim mbrojtjen e shëndetit si të dhuruesit ashtu edhe të pacientit.
2. Pyetjet që përmban pyetësi janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të jenë të lehta për t'u kuptuar me qëllim që të arrihet të merret një përgjigje e saktë dhe sa më e vërtetë, dhe bëhen me qëllim që të verifikohet nëse kandidati për dhurues gjaku i ka kuptuar siç duhet materialet informative të përmendura në pjesën e parë të kësaj rregullore, duke i dhënë mundësinë atij t'i drejtojë pyetje personelit shëndetësor të strukturës transfuzionale dhe në të njëjtën kohë t'i kërkojë atij në çdo moment një procedurë konfidenciale vetëpërfundimtare.
  3. Pyetësi i plotësuar në çdo pjesë nënshkruhet nga kandidati dhurues dhe nga personeli shëndetësor që ka kryer intervistën.
  4. Pyetësi plotësohet me të gjitha të dhënat anamnestike personale dhe në çdo dhurim të mëtejshëm plotësohet me të dhëna të tjera.

### **Neni 8**

#### **Vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të shëndetit të dhuruesit**

1. Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të dhuruesit ka për qëllim evidentimin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore të kandidatit për dhurues gjaku duke i kushtuar vëmendje të veçantë gjendjeve të paaftësisë mendore, hiponutricionit, edemave, anemisë, ikterit, cianozës, dispense, paqëndrueshmërisë mendore, intoksikimit alkoolik, përdorim drogash apo abuzim me medikamente.
2. Rezultatet e vlerësimit dokumentohen në kartelën klinike dhe pyetësin e dhuruesit të gjakut (Aneksi I pjesa A dhe C).

### **Neni 9**

#### **Qartësimi i të dhënave fizike për pranimin e kandidatit dhurues gjaku.**

1. Përpara çdo dhurimi mjeku përgjegjës për seleksionimin qartëson që kandidati për dhurim gjaku, plotëson të gjitha të dhënat fizike të duhura për të dhuruar gjak të plote apo komponentë nëpërmjet aferezës, sipas nenit 8, 9 më sipër dhe aneksit 3 të kësaj rregullore.
2. Mjeku i sipërpërmendur në bazë të gjyqimit të tij mund të rekomandojë kryerjen e hetimeve të mëtejshme klinike laboratorike apo ekzaminimeve të tjera të nevojshme për të përcaktuar përshtatshmërinë e kandidatit dhurues për të dhuruar gjak.
3. Të dhënat e mbledhura dhe rezultatet e hetimeve të kryera, shënohen në kartelën klinike të dhuruesit Aneksi 1 pjesa A dhe C.

### **Neni 10**

#### **Përkufizimi i gjykimit për përshtatshmërinë e dhuruesit për të dhuruar gjak**

1. Mjeku përgjegjës për seleksionimin, pasi ka qartësuar identitetin e kandidatit për dhurues, pasi ka mbledhur dhe vlerësuar të dhënat anamnesticke në respekt të kritereve të përjashtimit të përhershëm e të përkohshëm të përmbledhura në Aneksin 4, pasi ka vlerësuar gjendjen e përgjithshme të shëndetit të dhuruesit, pasi ka qartësuar ekzistencën e të dhënave fizike për pranimin e kandidatit dhurues sipas Aneksit 3 dhe duke mbajtur parasysh aty ku është e mundur edhe të dhënat klinike e laboratorike të dhurimeve të mëparshme, shpreh në mënyrë zyrtare gjykimin për përshtatshmërinë e dhuruesit për të dhuruar gjak.
2. Gjykimi mbi përshtatshmërinë për të dhuruar gjak duhet të shprehet për çdo dhurim dhe të pasqyrohet në kartelën klinike dhe pyetësin e dhuruesit (Aneksi 1 pjesa C e D).

### **Neni 11**

#### **Dhënia e pëlqimit për dhurim dhe për trajtimin e të dhënave personale**

1. Pasi janë kompletuar të gjitha procedurat e seleksionimit në bazë të cilave mjeku përgjegjës për seleksionimin e përcakton individin të përshtatshëm për të dhuruar gjak, ai i kërkon kandidatit dhurues të informuar paraprakisht, të shpreh pëlqimin e tij për dhurimin dhe për trajtimin e të dhënave personale sipas rregulloreve e ligjeve në fuqi duke firmosur në pjesën e duhur të pyetësit (Aneksi 1 pjesa B).
2. Nga deklarata e pëlqimit e cila duhet të firmoset nga vetë dhuruesi duhet të dalë e qartë se:
  - E ka lexuar materialin informativ për SIDA-n, të paraqitur në aneksi1, pjesa A e kësaj rregullore dhe e ka kuptuar qartë atë.
  - I është përgjigjur me vërtetësi pyetjeve të shtruara në pyetësor.
  - Është i ndërgjegjshëm se informacioni i dhënë mbi gjëndjen e tij shëndetësore e stilin e jetesës, përbën një element themelor për sigurinë e tij dhe për sigurinë e pacientit që do të marrë gjakun e tij.
  - Ka marrë një shpjegim të qartë e të detajuar mbi procedurën e dhurimit të gjakut dhe që i është dhënë mundësia për të bërë pyetje dhe eventualisht për të refuzuar procedurën.
  - Nuk ka dhuruar gjak në ndonjë vend tjetër brenda intervalit minimal të lejuar nga një dhurim në tjetrin.
  - E kryen këtë dhurim mbi baza vullnetarizmi.
  - Në 24 orët që pasojnë dhurimin nuk do të kryejë aktivitete apo veprime fizike të sforcuara.
3. Pëlqimi i dhuruesit duhet të merret për çdo lloj dhurimi: gjak i plotë, komponentë nëpërmjet ferezës, qeliza shtam periferike si edhe qeliza të kordonit umbilikal.

4. Për dhurimin e qelizave të kordonit umbilikal duhet që në deklaratën e pëlqimit të shtohet edhe një pikë ku nëna pranon përdorimin e këtyre qelizave në persona të tjerë.

### **Neni 12**

#### **Ekzaminime të detyrueshme për çdo dhurim gjaku, dhe për dhuruesit e rregullt**

1. Në çdo dhurim dhuruesit i nënshtrohen në mënyrë të detyrueshme të gjitha testimeve laboratorike të përcaktuara me ligj (Aneksi 1, pjesa E).
2. Rezultatet e testimeve hidhen në kartelën personale të dhuruesit.
3. Dhuruesit e rregullt, çdo vit, i nënshtrohet përveç ekzaminimeve të detyrueshme, (për agjentet infektive dhe atyre imunohematologjikë), edhe një serie ekzaminimesh të tjera shtesë (Aneksi 5), për të bërë një vlerësim më të plotë mbi gjendjen e tyre shëndetësore.

### **Kreu IV**

#### **Dhurimi i qelizave burimore hemopoetike**

### **Neni 13**

#### **Dhurimi i qelizave burimore hemopoetike periferike**

1. Kandidati për dhurues i qelizave burimore hemopoetike periferike duhet të ketë të njëjtat kërkesa të parashikuara për përshtatshmërinë e dhuruesit të gjakut të plotë. Ai vlerësohet në mënyrë të dyfishtë nga një mjek transfuziolog për risqe të ndryshme të lidhura me procedurën e mbledhjes dhe nga mjeku klinikist që ndjek për risqe të lidhura me marrësin ( për dhuruesin allogjenik).
2. Në raste të veçanta dhe në raste të kërkesave specifike klinike mund të adaptohen edhe kriteret e përshtatshmërisë të ndryshme në bazë të gjykimit të mjekut ekspert transfuziolog por edhe në respekt të mbrojtjes së shëndetit të dhuruesit.
3. Kandidati dhurues autolog ose allogjenik i qelizave burimore hemopoetike periferike hetohet edhe për agjentë infektive të transmetueshëm nëpërmjet transfuzionit jo më shumë se 30 ditë përpara dhurimit.

### **Neni 14**

#### **Dhurimi i qelizave staminale të kordonit umbilikal**

1. Kandidatja për dhuruese e gjakut të kordonit umbilikal duhet të jetë një person i shëndetshëm; procedura e përcaktimit të përshtatshmërisë duhet të përfshijë anamnezën familjare të dy prindërve të të porsalindurit duke i kushtuar shumë rëndësi sëmundjeve të trashëgueshme.

2. Kandidatja për dhuruese i nënshtrohet testeve për sëmundje infektive të transmetueshme dhe kjo jo më parë se tridhjetë ditë përpara dhurimit. Këto teste përsëriten edhe një here midis gjashtë dhe 12 muajve nga dhurimi i gjakut të kordonit umbilikal.
3. Shtatzënia duhet të ketë qënë normale. Neonati duhet të kontrollohet më në mënyrë të hollësishme në lindje, përpara mbledhjes së gjakut dhe në mënyrë të detyrueshme i nënshtrohet kontrollit mjekësor midis muajit të gjashtë dhe të dymbëdhjetë të jetës për të evidentuar praninë e sëmundjeve gjenetike përpara se gjaku i dhuruar nga kordoni umbilikal të përdoret.

## **Kreu V** **Regjistrimi dhe arkivimi**

### **Neni 15** **Gjurmimi i dhurimit**

1. Pranë çdo strukture transfuzionale ekziston dhe zbatohet sistemi i regjistrimit dhe arkivimi i të dhënave që lejon ndërtimin e gjithë rrugës së njësisë së gjakut apo komponentit nga momenti i mbledhjes deri në destinacionin final.
2. Të dhënat personale, klinike dhe laboratorike regjistrohen dhe azhurnohen në një skedar dhuruesish të menaxhuar në mënyrë elektronike apo manuale. Ky skedar mbahet në mënyrë të tillë që:
  - a. Të përmbajë emrin mbiemrin, seksin, vendin dhe datën e lindjes, rezidencën, të dhëna telefonike, shoqata apo federata vullnetarësh në të cilat është i angazhuar dhuruesi, dhe mundësisht të dhëna telefonike dhe adresa të vendit të punës së dhuruesit.
  - b. Të garantojë identifikimin e plotë të dhuruesit, të mbrojë identitetin e tij duke ju referuar së drejtës së tij për konfidencialitet, dhe brënda këtyre kushteve të sigurojë në të njëjtën kohë edhe gjurmimin e dhurimit.
  - c. Të lejojë futjen e të dhënave të lidhura me reaksione të mundshme të padëshirueshme të dhuruesit ndaj dhurimit të gjakut, motivet për të cilat nuk këshillohet të vazhdohet me tutje me dhurimin, përkohësisht apo në mënyrë të përhershme dhe të gjitha këto në respekt të konfidencialitetit
3. Veprimet e regjistrimit kryhen pasi është kryer çdo fazë e punës, ato duhet të jenë të lexueshme dhe të lejojnë identifikimin e operatorit në çdo fazë duke përfshirë edhe atë që është e lidhur me ruajtjen e regjistrimit.
4. Në rastin e reaksioneve të padëshirueshme të lidhura me transfuzionin duhet që nëpërmjet këtij skedari të arrihet tek dhuruesi, dhe të verifikohen rezultatet e të gjitha testeve të kryera dhe gjykimi final mbi bazën e tyre.



**Neni 16**  
**Ruajtja e të dhënave**

1. Dokumentacioni që lejon ndërtimin e rrugës së çdo njësie gjak apo komponenti që nga momenti i dhurimit deri në destinacionin final të tij, moduli i konsentit të informimit (pyetëtori) të lidhur me çdo dhurim (autolog apo allogjenik) si edhe rezultatet e testimeve për agjentë infektive të kryera mbi çdo njësi gjak apo komponent ruhen për 30 (tridhjetë) vjet.
2. Regjistrimet e rezultateve të lidhura me përcaktimin e grupit të gjakut ABO dhe RhD, vështirësitë e mundshme të vërejtura në përcaktimin e grupit të gjakut, ekzistencën e antitropave të parregullt, e reaksioneve transfuzionale si edhe të provave të pajtueshmërisë pre-transfuzionale (aty ku ato kryhen), ruhen për 15 vjet.
3. Regjistrimet e lidhura me temperaturën e ruajtjes së gjakut apo komponentëve dhe kontrollat e sterilitetit dhe të kontrollit të cilësisë, mbi komponentët, reagentët, pajisjet dhe rezultatet laboratorike ruhen për 12 muaj.

**Neni 17**  
**Dispozita Mbyllëse**

1. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe bankat e gjakut në rrethe.
2. Për mos zbatimin e kësaj rregulloreje organet e ngarkuara vendosin sanksionet përkatëse sipas ligjit “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha rregulloret dhe udhëzuesit e mëparshëm që trajtojnë këto probleme.
4. Për të ndjekur zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohet Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik dhe Inspektorati Shëndetësor Shtetëror.

**Neni 18**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**Aneksi 1**

**Skema e kartelës së dhuruesit të gjakut/komponentëve**

*Pjesa A*

*Të dhëna personale të dhuruesit*

Emri, Atësia, Mbiemri

Vendi dhe data e lindjes

Seksi

Profesioni

Vendi i punës

Adresa e plotë e banimit

Kontakte telefonike

Vendi i dhurimit

Dokumenti i identifikimit

Koha e dhurimit të fundit

Grupi i gjakut: ABO RhD

Struktura antigjenike

## Fleta informative për SIDA për dhuruesit e gjakut

I dashur dhurues/dhuruese

Ju po tregoni gatishmërinë që me anë të gjakut që ju dhuroni të ndihmoni pacientet që kanë nevojë për të. Në mënyrë që të mos dëmtohet as shëndeti juaj dhe as shëndeti i pacientit që do të marre gjakun tuaj, ju lutemi që të lexoni me shumë vëmendje si informacionin e dhënë në këtë fletë ashtu edhe pyetësorin që do t'ju jepet menjëherë pasi të keni lexuar këtë informacion. Në të njëjtën kohë ju terheqim vëmendjen që të gjitha pyetjeve t'i përgjigjeni qartë, pasi vetëm përgjigjet tuaja të sinqerta mund të lejojnë mjekët tanë që të gjykojnë në se ky dhurim gjaku bart ndonjë risk për ju apo për pacientin që do të marrë gjakun tuaj.

### Ç'është SIDA

SIDA është një gjendje e shkaktuar nga infeksioni me virusin HIV. Të gjitha shenjat e kësaj gjendjeje janë të lidhura me dobësimin e aftësisë mbrojtëse të organizmit pasi ai është infektuar me këtë virus. Virusin HIV transmetohet vetëm nëpërmjet kontakteve me lëngje trupore të infektuara (gjak, spermë, sekrecione vaginale). Sëmundja e SIDA-s zhvillohet disavite pas infektimit me virusin HIV. Pavarësisht gjithë arritjeve, deri tani nuk është gjetur një shërim për sëmundjen SIDA.

### Cilat simptoma flasin për SIDA

- Fryrje e pashpjegueshme e gjendrave limfatike
- Temperaturë e pashpjegueshme
- Djersitje e bollshme natën
- Kollë e zgjatur apo vështirësi në frymë
- Kruajtje të vazhdueshme apo plagë në gojë.
- Diarre e vazhdueshme
- Rënie e pashpjegueshme në peshë

### Kush janë personat apo sjelljet që ju ekspozojnë ndaj rrezikut të infeksioneve të transmetueshme nëpërmjet gjakut (si HIV/AIDS apo Hepatitet):

- Raportet seksuale me persona që i përkasin kategorive të riskuara
- (toksiko-dipendentet, prostitutat apo personat e panjohur)
- Mardhëniet seksuale me partnerë të ndryshëm apo shumë partnerë njëkohësisht
- Mardhëniet seksuale të kryera në këmbim të parave
- Mardhëniet seksuale me persona bartës të hepatitit apo AIDS
- Përdorimi i drogave të rënda
- Kontaktet apo kontaminimi i mundshëm i mukozës apo lëkurës së dëmtuar me gjak të një personi tjetër
- Personat që kanë pasur një rezultat pozitiv në analizat për HIV/AIDS apo Hepatit.

### Përse duhet që në asnjë mënyrë të mos dhurojnë gjak personat që bëjnë pjesë në ndonjë prej grupeve të rrezikuara për HIV/SIDA.

Pas hyrjes së virusit HIV në organizëm, ky përgjigjet duke krijuar disa antitropa kundërvirusi. Formimi i antitropave zgjat një periudhë të caktuar, pra ato nuk ndodhen në gjak për disa javë deri në disa muaj pas hyrjes së virusit në organizmin e njeriut. Sot në laboratorët

e testimit të gjakut të dhuruar, zbulohet vetëm prania e këtyre antitropave. Kjo do të thotë se disa persona mund të jenë infektuar para pak kohe, ndërkohë që kontrolli në laborator nuk i zbulon si të tilla. Ky fakt përbën një rrezik të madh për pacientin, që do të transfuzohet me këtë gjak. Për këtë arsye:

Të gjithë personat e grupeve të rrezikuara, të rradhitur me sipër Nuk duhet të dhurojnë gjak Nuk duhet të kryheni në asnjë mënyrë, një dhurim gjaku, me qëllim që të bëni analizat për HIV

Nëse Ju keni dyshimin më të vogël se jeni prekur nga kjo sëmundje, ju lutem mos dhuroni gjak.

Për këtë arsye, nuk duhet të pranoni dhe nënshkruani në pyetësor që nuk i përkasin asnjë prej grupeve të sipërpërmendura dhe se gjaku juaj mund t'i jepet pa merak çdo pacienti që ka nevojë për të.

**Cfare pasojash mund të ketë një person që me ndërgjegje, jep përgjigje të pasakta?**

Kush e di që bën pjesë në një grup të rrezikuar për infeksionin e HIV dhe dhuron gjak, konsiderohet që i shkakton një dëmtim trupor me paramendim, pacientit që do trajtohet me këtë gjak. Ju lutem mirëkuptoni këto masa dhe mendoni se kjo është në të mirën tuaj apo të afërmeve tuaj, pasi një ditë edhe Ju mund të jeni pacient.

**PYETSORI****Vendosni kryqin në opsionin që ju përshtatet**

Aktualisht	Po	Jo	01	Ndiheni mirë me shëndet?
Në javën e fundit	Po	Jo	02	Keni patur infeksione (përfshirë dhe ftohje) ndryshime në lëkurë, plagë apo gjëndra të fryra të dukshme?
	Po	Jo	03	A keni kryer trajtim tek dentisti?
Në 2 javët e fundit	Po	Jo	04	Jeni trajtuar me medikamente? Cilat?
	Po	Jo	05	Keni bërë trajtime mjekësore për ndonjë sëmundje? A vazhdoni ta keni këtë sëmundje?
Në 4 javët e fundit	Po	Jo	06	Keni patur temperaturë apo sëmundje infektive (duke përfshirë të ftohtin)?
	Po	Jo	07	Keni bërë ndonjë vaksinë? Cilën?
	Po	Jo	08	Keni patur diarre?
Në 6-muajt e fundit	Po	Jo	09	A keni kryer ndonjë operacion, endoskopi apo keni patur ndonjë shtatzani?
	Po	Jo	10	Jeni trajtuar me gjak, plazmë ose produkte të tjera të gjakut?
	Po	Jo	11	Keni kryer akupunkte, tatuazhe, piercing, apo shpime te veshëve?
Në 12muajt e fundit	Po	Jo	12	A keni bere imunizim ndaj sëmundjes se tërbimit apo ndonjë imunizim tjetër pasiv?
	Po	Jo	13	A keni qëndruar në zona me rrezik ndaj Malariae? A keni pasur probleme ose ethe gjatë/pas qëndrimit tuaj atje?
	Po	Jo	14	A keni patur kontakte intime me persona me risk të lartë ndaj Hepatitit ose HIV-it? (shiko fletën informative për SIDA-n)
	Po	Jo	15	A jeni shpuar me materiale të infektuara?
	Po	Jo	16	A keni marrë barna të tipit Roaccutan, Neotigason, Propecia për sëmundje të lëkurës apo rënie flokësh?
	Po	Jo	17	A keni patur varësi nga alkooli apo medikamente? Keni marrë gjatë kësaj periudhe droga të ndryshme (hashash etj)?
Në 2 vitet e fundit	Po	Jo	18	A keni patur sëmundje të zemrës, diabetit, sëmundje të gjakut, apo turbekulozit?
Gjatë gjithë jetës suaj	Po	Jo	19	A keni patur tumore malinje apo Osteomielite?
	Po	Jo	20	A keni patur sëmundje shumë të rënda (të cilat nuk janë të shkruara këtu)? Nëse po, Cilat?

Përcaktimi i përshtatshmërisë së dhuruesve të gjakut

	Po	Jo	21	A keni patur Malarie, Sifiliz ose sëmundje shumë të rralla si Babesioza, Bruceloza, Leishmanioza, Lepra, Tularemia?
	Po	Jo	22	A keni kryer transplant të dura mater, cornese apo ndonjë lloj tjetër? Çfarë?
	Po	Jo	23	A jeni trajtuar me hormone të hypofizës apo me hormone të tjera?
	Po	Jo	24	Keni patur histori familjare të sëmundjes Creutzfeldt Jakob?
	Po	Jo	25	A keni patur infeksion HIV(SIDA) ose Hepatit?
	Po	Jo	26	<b><i>Jeni i sigurt që nuk bëni pjesë në personat me risk për infeksion HIV (shiko informacionin për SIDA-n)</i></b>

## ***Pjesa B***

### Deklarata e dhuruesit

Unë deklaroj se:

- Të dhënat me sipër (emri, mbiemri, adresa) janë të dhënat e mia personale dhe Unë miratoj përpunimin e tyre.
- Unë pranoj që gjaku i dhuruar prej meje, t'i nënshtrohet analizave të detyrueshme (për HIV/SIDA apo edhe për qëllime të tjera me karakter studimor) dhe të dhënat e mia të ruhen në këtë Institucion.
- Kam marrë një shpjegim të detajuar dhe të kuptueshëm mbi procedurën e dhurimit të gjakut dhe me është dhënë mundësia të bëj pyetje e rrjedhimisht të tërhiqem nga dhurimi i gjakut nëse dua.
- Nuk kam dhuruar gjak/komponentë brenda intervalit minimal të parashikuar nga ligji, midis dy dhurimeve.
- I kam lexuar dhe kuptuar fletët informative për HIV/SIDA, që më janë paraqitur përpara dhurimit të gjakut. Unë nuk di, me dijeninë time, asnjë shkak të njohur që më përjashton nga dhurimi i gjakut.
- I kam lexuar, kuptuar dhe përgjigjur me vërtetësi pyetjeve në këtë pyetësor. Unë e kam të qartë se përgjigjet e pa sakta mund të dëmtojnë shëndetin tim ose atë të marrësit të gjakut tim apo edhe të çojnë deri në vdekje të tij.
- Në se do të kemë ndonjë dyshim mbi aftësinë time për të dhuruar gjak do t'i drejtohem një mjeku të qendrës së dhurimit të gjakut.
- Jam informuar gjithashtu edhe mbi efektet anësore të mundshme, të padëshirueshme, që mund të shfaqen në persona të caktuar gjatë apo pas dhurimit të gjakut.
- Dhuroj gjak me vullnetin tim të plotë e se nuk do të zhvillojë asnjë aktivitet apo hobi tjetër të rrezikshëm brenda 24 orëve të ardhshme.
- Deklaroj se nuk i përkas grupeve të rrezikuara për HIV/SIDA (sipas fletës -informative për SIDA).
- Deklaroj se në 12 muajt e fundit nuk kam pasur marrëdhënie seksuale me persona që bëjnë pjesë në këto grupe risku.

**Për këtë arsye, unë nuk kam asnjë merak që gjaku im t'u transfuzohet pacientëve që kanë nevojë për të.**

Data \_\_\_\_\_ (Emër, Mbiemër) \_\_\_\_\_

Firma:

***Pjesa C***

Vlerësimi i të dhënave fizike për të dhuruar gjak

Pesha kg	Hb g/dl	Temp: °C	TA mm/Hg	Pulsi /minutë

Shënime të mjekut:

Vlerësim i gjëndjes shëndetësore të dhuruesit/ të dhëna anamnestike me relevance klinike.

Data:

Firma:

***Pjesa D***

Gjykimi i përshtatshmërisë për të dhuruar

I përshtatshëm për të dhuruar gjak \_\_\_\_\_

Përrjashtuar përrkohësisht (arsyeja) \_\_\_\_\_

Kohëzgjatja e përrjashtimit \_\_\_\_\_

Kontrolli i ardhshëm \_\_\_\_\_

Përrjashtuar përrgjithmonë (arsyeja) \_\_\_\_\_

Emër Mbiemër, firma e mjekut përrgjegjë për seleksionimin.

\_\_\_\_\_



***Pjesa E***

*Ekzaminime të detyrueshme për çdo dhurim*

- *Ekzaminime për agjente infektivë:*

Data \_\_\_\_\_

HbsAg	HIV	HCV	Sifilis	ALT

Emër Mbiemër (personi që kryen testimin) \_\_\_\_\_

Firma \_\_\_\_\_ Firma e mjekut \_\_\_\_\_

- *Ekzaminime imunohematologjike:*

Data \_\_\_\_\_

Grupi i Gjakut ABO dhe RhD \_\_\_\_\_

Struktura antigjenike Rezus dhe Kell \_\_\_\_\_

Kontrolli për antitrupa të parregullt (ICT) \_\_\_\_\_

Emër Mbiemër (personi që kryen testimin) \_\_\_\_\_

Firma \_\_\_\_\_ Firma e mjekut \_\_\_\_\_

### Aneksi 3

#### **Kritere të pranimit të dhuruesve të gjakut të plotë dhe të komponentëve (nuk janë të vlefshme për dhuruesit autologe)**

##### **1. Moshë dhe pesha**

Moshë	18 deri 65 vjeç	
	17-18 vjeç	Nëse dhurohet për të afërm dhe pas pëlqimit me shkrim të prindërve apo kujdestarëve ligjorë
	Dhurues për herë të parë mbi 60 vjeç	Në bazë të gjykimit të mjekut seleksionues dhe nën përgjegjësinë e tij
	Dhurues mbi 65 vjeç	Me aprovimin e mjekut transfuziolog.
Pesha trupore	Mbi 50 kg, sasia e dhurimit $450 \pm 10\%$	Sipas gjykimit të mjekut transfuziolog.

##### **2. Niveli i hemoglobinës në gjakun e dhuruesit**

Hemoglobina	Për femra $\geq 12.5$ g/dl	Për meshkuj $\geq 13.5$ g/dl	E vlefshme për dhuruesit allogjenik të gjakut të plotë dhe të komp.qelizor
-------------	----------------------------	------------------------------	--

##### **3. Niveli i proteinës në gjakun e dhuruesit**

Proteina	$\geq 60$ g/l	Proteinemia për dhuruesit e plazmës duhet të kryhet të paktën çdo vit
----------	---------------	---

##### **4. Niveli i trombociteve në gjakun e dhuruesit**

Trombocitet	Numri i trombociteve $\geq 180 \times 10^9/l$	Ky nivel trombocitesh kërkohet për dhuruesit me aferezë.
-------------	---	--

##### **5. Presioni arterial**

Presioni arterial sistolik duhet të jetë midis 110-180 mmHg

Presioni arterial diastolik duhet të jetë midis 60-100 mmHg

##### **6. Puls**

Pulsi duhet të jetë ritmik dhe i rregullt dhe frekuenca duhet të jetë midis 50-100/minutë. Për kandidatët dhurues të cilët praktikojnë stërvitje intensive mund të pranohet edhe një frekuencë më e ulët kardiace.

#### **Aneksi 4**

### **Kritere të përjashtimit të përhershëm apo të përkohshëm të kandidatit për dhurues me qëllim mbrojtjen e shëndetit të dhuruesit.**

Kandidati për dhurues i prekur aktualisht ose më parë nga sëmundjet e mëposhtme duhet të **përjashtohet përgjithmonë** nga dhurimi i gjakut në mbrojtje të shëndetit të tij.

Sëmundje autoimune	Me përjashtim të Sëmundjes Celiache me kusht që dhuruesi të ndjekë një dietë rigoroze pa gluten.
Sëmundjet kardiovaskulare: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Angina pectoris</li> <li>- Aritmi të rënda</li> <li>- Koronaropati</li> <li>- Infarkt Miokardi</li> <li>- Tromboza venozë/arteriale</li> <li>- Sind. EPË</li> <li>- Morbus Reynaud</li> <li>- Prolaps v. Mitrale-extrasistola</li> <li>- Valvulopatite</li> </ul>	Dhuruesit me sëmundje kardiovaskulare në proces apo të kaluara me përjashtim të sëmundjeve kardiovaskulare të lindura të cilat janë kuruar totalisht.
Sëmundje neurologjike: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Epilepsi</li> <li>- Sinkope dhe/ose konvulsione</li> <li>- Neuropati sistemike</li> <li>- Patologjitë degjenerative ose vaskulare të SNQ</li> <li>- Psikoza, demence</li> <li>- Neuro-kirurgjitë</li> <li>- Trauma kraniale me humbje të koshiencës.</li> </ul>	Histori sëmundjesh serioze të SNQ Nuk dhurojnë Konvulsione të ndryshme nga ato febrile infantile me përjashtim të atyre për të cilat kanë kaluar 3 vjet nga terapia e fundit antikonvulsive pa rishfaqje të krizës.
Steroide, hormone anabolizante, apo hormone të rritjes.	Nuk dhurojnë
Neoplazi ose sëmundje malinje	Me përjashtim të Ca. in situ me shërim komplet
Sëmundjet hematologjike: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Eritropatite e rënda (Favizmi, policitemia, hemokromatoza)</li> <li>- Sind. Mieloproliferative</li> </ul>	Nuk dhurojnë
Tendencë për hemorragji jo-normale  Apo që marrin Antikoagulantë	Kandidate për dhurues të cilët japin një histori koagulopatie të lindur apo të fituar. Nuk dhurojnë
Psoriazis e gjeneralizuar	Nuk dhurojnë
Astma bronkiale, simptomatike me terapi	Nuk dhurojnë

Përcaktimi i përshtatshmërisë së dhuruesve të gjakut

sistemike. Bronkite kronik të formave të rënda (emfizematik, pneumokoniozë)	
Sëmundje endokrine: - Hipertiroidizëm i trajtuar me Tapazole - Pankreasi - Surrenalet - Hipofizës - Paratiroidës	Nuk dhurojnë, në të gjitha rastet e patologjive neoplazike apo auto-immune. Nuk dhurojnë
Sëmundje Gastroenterike: - Rezekcion të stomakut - Morbus Crohn - Koliti ulceroz - Divertikuloza - Varice ezofagut - Sind. Gilbert	Nuk dhurojnë
Sëmundje Ap. Urogenital: - Glomerulonefrit kronik - Insufficence renale - Pielonefrit - Adenome e prostatës (PSA>7ng/ml)	Nuk dhurojnë
Sëmundje Oftalmike: - Retinopatite - Degjenerim i Makulës	Nuk dhurojnë
Diabeti me Insulinë	Nuk dhurojnë
Transplante (Korneas, Dura mater)	Nuk dhurojnë

Kandidati për dhurues i prekur aktualisht nga sëmundjet e mëposhtme duhet të **përrjashtohet përkohësisht** nga dhurimi i gjakut në mbrojtje të shëndetit të tij.

Temperaturë >38°C	Deri 7 ditë nga normalizimi saj
Frakturë të kockave	Deri 15 ditë pas heqjes së allçisë.
Intevente kirurgjikale Minore: Madhore (abdomen, kocka, muskuj)	Deri në 7 ditë pas ndërhyrjes Deri në 6 muaj pas interventit
Shtazania: - Pas lindjes - Ushqyerje me gji - Aborte para 3-mujorit të parë - Aborte pas 3-mujorit të dytë	Pezullim për një vit Pezullim deri 15 ditë nga mbarimi. Pezullim deri në 6-muaj Pezullim deri në një vit
Nëse përdoren medikamentet e mëposhtme:	

<p><u>Antibiotik dhe/ose antimykotik</u></p> <p><u>Antiagragantë (Aspirina)</u></p> <p><u>Antikolinergjikë (Atropina etj)</u></p> <p><u>Antihipertensivë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• nëse përdor vetëm β-blokues (Propanololi)</li> <li>• nëse përdor ACE-inhibitorët (Captopril, enalapril, lisinopril)</li> </ul> <p><u>Anti-inflamatore</u> (Aspirin, ibuprofen, naproxen)</p> <p><u>Anti-parazitare</u></p> <p><u>Antipropulsive (Loperamid)</u></p> <p><u>Kortizonik</u></p> <p><u>Heparinë</u></p> <p><u>Psikotikë (vetëm med.anksiolotik)</u></p>	<p>Pezullim deri 15 ditë nga mbarimi i terapisë.</p> <p><b>Jo</b> për trombocit vetëm gjak të plotë</p> <p>Pezullim për 7 ditë</p> <p>Pezullohen</p> <p>Pas dhurimit duhet të mbahet shtrirë për të paktën 15 min.</p> <p>Nuk bën dhurime me aferezë të produkteve të gjakut.</p> <p>Pezullohen për 7-ditë vetëm për dhurimin e trombociteve.</p> <p>Pezullohen për 15 ditë</p> <p>Pezullohen për 15 ditë</p> <p>Pezullohen për 15 ditë</p> <p>Pezullohen për 15 ditë</p> <p>Dhurojnë</p>
<p>Patologji hepatike imunologjike, metabolike apo respiratore</p>	<p>Pezullohen kandidatët për dhurues me prekje të rëndë aktive, kronike apo recidivuese.</p>
<p>Sëmundje Gastroenterike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ulcera peptike</li> <li>- Infeksionet akute GI</li> </ul>	<p>Pezullim i përkohshëm deri në shërimin e plotë, të dokumentuar.</p> <p>Pezullim deri në 15 ditë nga shërimi</p>
<p>Sëmundjet hematologjike:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hemokromatozat pa dëmtime të organeve</li> <li>- Talasemi heterozigote</li> </ul>	<p>Dhurojnë, por Jo më shpesh se një herë në çdo 3-muaj</p> <p>Dhurojnë gjak max. 1 herë në vit.</p>
<p>Transfuzion të gjakut dhe/ose produkteve të tij.</p>	<p>Pezullohen për 6-muaj</p>
<p>Sëmundje endokrine:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tiroide</li> <li>- Pankreatit</li> <li>- Surrenalet</li> <li>- Hipofizës</li> <li>- Paratiroides</li> <li>- Të tjera</li> </ul>	<p>Pezullim i përkohshëm për dhurim, në të gjitha rastet e patologjive inflamatore, deri në shërimin e plotë të simptomave dhe stabilizimin e funksionit.</p>
<p>Sëmundje Ap. Urogenital:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Glomerulonefriti akut</li> <li>- Cistite, cistopieliti.</li> </ul>	<p>Pezullim deri 5-vjet pas shërimit.</p> <p>Dhurojnë</p>
<p>Diabet</p>	<p>I korigjueshem vetem nga dieta.</p>
<p><u>Sëmundje alergjike</u> medikamentoze të formave të rënda.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Polinozat</li> <li>• Me terapi desensibilizuese</li> </ul>	<p>Pezullohen nga dhurimi për 1 vit</p> <p>Pezullohen deri në fund të sezonit të riskut (alergjisë)</p> <p>Pezullim deri në 72 orë nga vaksina e fundit.</p>

Patologji Dermosifilopatie : - Uretriti jo specifik - Gonorea, Kondilomi - Vitiligo jo e gjeneralizuar	Pezullim i përkohshëm deri në shërimin klinik të plotë. Pezullim i përkohshëm deri 4-muaj nga përfundimi i terapisë.
---	---

Duhet theksuar se mund të ekzistojnë motive për të cilat është e nevojshme që me qëllim mbrojtjen e shëndetit të kandidatit dhurues të shtyhet dhurimi; vendimi për zgjatjen e periudhës së shtyrjes së dhurimit mbetet në përgjegjësinë e mjekut të seleksionimit.

Mjeku përgjegjës për dhurimin, në raste të veçanta, mund të kërkojë dhe mendimin e një mjeku specialist përpara se të formulojë gjykimin e tij mbi përshtatshmërinë e dhuruesit për të dhuruar gjak/komponentë.

Shtatzënia përbën një shkak për përjashtim të përkohshëm, për një vit pas lindjes, dhe për gjashtë muaj pas ndërprerjes së shtatzënisë, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme dhe nën përgjegjësinë e mjekut kurues.

### VAKSINIMET

<i>Viruse ose baktere të dobësuar:</i> shytat, fruthi, rubeola, varicela, ethja e verdhë, poliomieliti-Sabin (per os) tifo (per os), BCG.	4 javë nga inokulimi
<i>Viruse, baktere ose riketcie të inaktivizuara/të ngordhura:</i> Hepatiti A/B, gripi, kolera, murtaja, difteria-tetanozi-pertusi, meningjiti meningokoksik, papiloma virus, poliomieliti (Salk), tifo (Iniez).	48 orë nga inokulimi dhe nëse subjekti është asimptomatik
Rabies (Terbimi)	Nëse subjekti është asimptomatik dhe nëse nuk ka pasur ekspozim <b>Përjashtohet për 48 orë</b> Nëse vaksina është administruar pas ekspozimit <b>Perjashtohet per nje vit.</b>
Vaksina për encefalitin nga riqerat	Nëse subjekti është asimptomatik dhe nëse nuk ka pasur ekspozim <b>Përjashtohet për 48 orë</b> Nëse vaksina është administruar pas ekspozimit <b>Përjashtohet për një vit.</b>

**Kritere për përjashtimin e përhershëm apo të përkohshëm të kandidatit për dhurues me qëllim mbrojtjen e shëndetit të marrësit**

**Përjashtim i përhershëm**

Kandidati për dhurues i prekur aktualisht apo i prekur më parë nga një prej patologjive apo gjëndjeve të mëposhtme duhet të deklarohet si i papërshtatshëm për të dhuruar gjak apo komponentë me qëllim mbrojtjen e **shëndetit të marrësit** të gjakut.

Përdorues i drogave i/v apo edhe atyre sintetike per os	Nuk dhurojnë
Alkolizëm kronik	Nuk dhurojnë
Patologji Dermato-sifilopatike : - Sëmundje të lëkurës me origjinë bakteriale/virale në fazën akute - Sifilizi - Granuloma inguinale - Limfogramuloma venero	Nuk dhurojnë (si në format akute apo dhe në ato kronike qofshin ato)
Sëmundje infektive: - Amebiaza, Encefaliti (arbovirus) - Babesioza - Ethen Q - Lebra - Kala-Azar (Leishmanioza viscerale) - Leishmanioza - Tripanosoma Cruzi (M. Chagas) - Encefalopatia Spongiforme e Transmetueshme (EST) p.sh Sëmundja Creutzfeld-Jacob*, varianti i ri i sëmundjes Creutzfeld-Jacob.	Nuk dhurojnë
Hepatitet: - Hepatite me etiologji të pa përcaktuar - Hepatiti C - Hepatiti B (me përjashtim të personave të cilëve u është negativizuar HBsAg dhe janë anti-HbsAb pozitiv) - HIV 1/2	Nuk dhurojnë
Marrja e substancave farmakologjike:	Nuk dhurojnë: Personat me histori përdorimi të substancave farmakologjike pa përshkrimin e mjekut, me rrugë i.m ose i.v, përfshirë lëndët narkotike, steroide apo hormone të ndryshme.
Marrësit e një ksenotransplanti	Nuk dhurojnë
Sjellja seksuale	Persona të cilët sjellja seksuale i ekspozon ndaj një risku të lartë për të marrë

	sëmundje infektive
--	--------------------

\* Persona me histori mjekësore apo familjarë të cilët bartin një risk për të pasur EST, duke përfshirë edhe dhuruesit që i janë nënshtruar një transplant të kornesë dhe/ose dura mater dhe/ose në të kaluarën janë kuruar me medikamente të ekstraktuara nga gjëndra hipofizës njerëzore. Kandidatë për dhurues të cilët kanë qëndruar në periudhën 1980-1996 në Mbretërinë e Bashkuar; apo kandidatë për dhurues që kanë marrë transfuzione allogjenike në Mbretërinë e Bashkuar pas vitit 1980.

### Përfshirja e përkohshme

Në prani të një prej patologjive të mëposhtme kandidati për dhurues duhet të deklarohet si përkohësishëm i papërshtatshëm për dhurimin e gjakut ose komponentëve për një periudhë kohe të ndryshueshme në varësi të patologjisë dhe të gjëndjes në fjalë.

INFEKSIONI: si rregull i përgjithshëm përfshirja mund të formulohet: pas një sëmundje infektive dhuruesit përfshihen nga dhurimi për të paktën 2 javë duke u nisur nga dita e shërimit të plotë klinik.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa patologji dhe kohëzgjatja e përfshirjes:

Trajtime Odontoiatrike: - Trajtime konservative - Heqje, pastrim mbushje dentare - Implantologji	Pezullim për 48 orë Pezullim për 7 ditë Pezullim për 4-muaj
Bruceleza	<b>2 vjet</b> nga shërimi i plotë
Osteomieliti	<b>2 vjet</b> nga shërimi i plotë
Ethen e verdhë	<b>6 muaj</b> nga shërimi i plotë
Tuberkulozi	<b>2 vjet</b> nga shërimi i plotë
Shistomiaza	<b>2 vjet</b> nga shërimi i plotë
Ethet reumatizmale (Reumatoidi articular akut)	<b>2 vjet</b> pas shuarjes së simptomave në mungesë të kardiopatisë kronike
Sars	<b>3 muaj</b> nga shërimi i plotë
Tifo-Paratifo	<b>1 muaj</b> nga shërimi i plotë
Toxoplasmosa, Mononukleoza infektive-CMV Morbus Di Lyme	<b>6 muaj</b> pas shërimit të plotë
Prekje të tipit gripal (Influenca)	2 javë pas shërimit të plotë klinik
<b>Malaria</b> Individë të cilët kanë jetuar në zona malarike: - 5 vitet e para të jetës - 5 vjet rresht gjatë jetës së tyre	Përfshirje nga dhurimi i gjakut të plotë, eritrociteve dhe trombociteve për <b>tre vjet</b> që pasojnë kthimin e tyre nga vizita e fundit në zonën endemike, me kusht që gjatë kësaj kohe dhuruesi të jetë asimptomatik



Individë me histori malarie	<b>3 vjet</b> pas shërimit të plotë klinik. Më pas pranohen vetëm pasi një test imunologjik ose molekular rezulton negativ
Vizitore asimptomatike në zonat endemike	<b>6 muaj</b> pas largimit nga zona endemike, ose mund të pranohen pasi një test imunologjik ose molekular është negativ.
Individe me një histori sëmundje febrile të padiagnostikuar gjatë, ose brenda gjashtë muajve pas kthimit nga vizita në një zonë endemike.	<b>3 vjet</b> pas shërimit klinik të plotë, kjo periudhë mund të reduktohet në 4 muaj nëse një test imunologjik ose molekular rezulton negativ.
Ëest Nile Virus (ËNV)	28 dite pas shërimit të plotë klinik ose largimit nga vendi ku mund të ketë pasur një transmetim në proces të virusit tek njerëzit.
Udhëtime në zona endemike për sëmundje tropikale (jo malarike)	3 muaj pas kthimit (të vlerësohet gjendja shëndetësore e dhuruesit pas kthimit)

Ekspozime në risk për të takuar një infeksion të transmetueshëm nëpërmjet gjakut

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekzaminime endoskopike</li> <li>- Agopunktura e kryer jo nga profesionistë e nëse nuk kryhet me agë me një përdorim</li> <li>- Spërkatje e mukozave me gjak</li> <li>- Shpim me aksidental me agë të përdorura</li> <li>- Transfuzion gjaku/komponentë ose administrim hemoderivatesh</li> <li>- Transplant i indeve apo qelizave me origjinë humane</li> <li>- Tatuazhe ose piercing</li> <li>- Persona në risk për shkak të një kontakti të ngushtë në kushte shtëpie me persona të prekur nga hepatiti B</li> <li>- Raporte seksuale rastësore në risk për transmetimin e Sem.Inf</li> <li>- raporte seksuale me persona të infektuar ose në risk për infeksione nga HBV, HCV, HIV.</li> <li>- Ndërhyrje kirurgjikale madhore*</li> </ul>	<p>Pezullim deri në 6 muaj pas ekspozimit të fundit në risk</p>
---	---

(\*) Në të gjitha këto raste duhet të vlerësohet edhe patologjia bazë për të cilën dhuruesi i është nënshtruar transfuzionit të gjakut/komponentëve, një interveni madhor kirurgjikal

apo ka marrë transplante indore/qelizore, pasi edhe patologjia bazë mund të përbëje shkak për përjashtim të përhershëm apo të përkohshëm të tij.

### Të tjera përjashtime të përkohshme

Ndërhyrje kirurgjikale minore	1 javë
Trajtime tek dentisti	Trajtime minor tek dentisti përjashtohen për 24 orë (ekstraksionet, mbushjet në rrënjë dhe trajtime të ngjashme konsiderohen si kirurgji minore).
Terapia	Përjashtimi bëhet për një periudhë të ndryshueshme në varësi të përbërësit aktiv të medikamentit të përkohshëm, farmakokinetikës së tij dhe sëmundjes bazë për të cilën merret kjo terapi.
Situata epidemiologjike të veçanta (p.sh vatra sëmundjesh)	Përjashtim në varësi të situatës epidemiologjike
Alergji nga medikamentet	Me vëmendje të veçantë ndaj penicilinës. Përjashtimi është për një vit nga ekspozimi i fundit.

### Kritere përjashtimi për dhuruesit autologe

Sëmundje kardiake serioze	Në varësi të ndërtimit klinik të strukturës së mbledhjes së gjakut
Persona të prekur aktualisht ose me histori të <ul style="list-style-type: none"> <li>- Hepatitit B, me përjashtim të personave HbsAg negativë të cilët demonstrojnë të jenë imune.</li> <li>- Hepatiti C</li> <li>- HIV 1/2</li> </ul>	
Infeksion bakterial aktiv	

## **Aneksi 5**

### **Ekzaminime të detyrueshme për çdo dhurim dhe kontrole periodike**

**A.** Në çdo dhurim dhuruesi duhet të kryejë një kontroll të gjakut komplet

**B.** Testime biologjike

Mbi çdo dhurim rezultati i testimit për ALT me metodën e validuar në dispozicion nuk duhet të jetë më i lartë se dyfishi i normës.

Çdo dhurim duhet të rezultojë negativ për ekzaminimet e mëposhtme:  
(për të gjitha rrethet e vendit)

- HIV 1/2 Ag/Ab
- HBsAg;
- HCV-Ab;
- Sifilis

Në rastin kur dhurimet rezultojnë pozitive për ndonjë nga këto testime virologjike fillestare atëherë testimi do të vazhdojë sipas algoritmit të paraqitur në rregulloren përkatëse.

Në dhurimin e tij të parë dhuruesi i nënshtrohet të paktën kontrolleve imunologjike të mëposhtme:

- Përcaktimi i grupit ABO direkt dhe indirekt
- Përcaktimi i fenotipit Rh komplet
- Kërkim antitropash të parregullt anti-eritrocitare.

Në dhurimet e mëtejshme duhet të konfirmohet grupi ABO dhe Rh D dhe kontrolli për antitropa të parregullt në rastin e stimulimit imunologjik të dhuruesit.

**C.** Ekzaminime për dhuruesit e rregullt/periodike

Dhuruesi i rregullt/periodik përveç ekzaminimeve të përmendura në pikat A dhe B çdo vit i nënshtrohet ekzaminimeve të mëposhtme, shtesë:

- Kreatinemi
- Glicemi
- Protein totale
- Kolesterollemi
- Trigliceridemi
- Ferritinemi